

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
Nr.regj. 05-3583/1
29.09.2022
Shkup

Në bazë të nenit 20 paragrafi 1 alineja 1 dhe 15 dhe në lidhje me nenin 18 paragrafi 1 alineja 18 nga Ligji për shërbime Mediatike audio dhe Audiovizuele ("Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë se Veriut" nr. 42/20 dhe 77/21), nenet 4, 6, 7, 9, 10 dhe 11 nga Ligji për donacione dhe sponsorisime të veprimtarive publike ("Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/06, 86/08, 51/11, 28/14 dhe 153/15) neni 39 paragrafi 1 alinetë 1 dhe 15 nga Ligji për shërbime Mediatike audio dhe Audiovizuele (tekst i spastruar) nr.ark.01-3732/1 nga data 29.07.2019, Zyra e Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr.ark. 08- 2520/2 nga data 16.09.2022 (nr. ynë arkivor. 03-3483/1 nga data 20.09.2022), Kërkesa e EF-EM 90.3 – SPORTSKO RADIO SHPKNJP import-eksport Shkup, që është dorëzuar deri te Agjencia, për përkrahje të një ngjarje tradicionale "Turne në futboll të vogël për media 2022, nr.0306-5/2022 nga data 26.09.2022 (nr. ynë arkivor.05-3518/1 nga data 26.09.2022, Drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike audio dhe Audiovizuele, miratoi si vijon:

V E N D I M

për ndarjen e ndihmës financiare - donacioni
për EF-EM 90.3 – SPORTSKO RADIO SHPKNJP import-eksport Shkup për organizimin e
jubileut të 30-të „ Turne në futboll të vogël për media 2022 “

1. Ndahet ndihmë financiare – donacion për EF-EM 90.3 – SPORTSKO RADIO SHPKNJP import-eksport Shkup, në shumën prej 250.000,00 (dyqind e pesëdhjetë mijë) denarë, me qëllim të përkrahjes së aktiviteteve të radiodifuzerit për organizimin e jubileut të 30-të ndërkombëtar "Turne në futboll të vogël për media 2022" që do të kontribuojë për promovimin e sportit profesional dhe rekreativ, stimulimin dhe zhvillimin e kulturës fer-plej.

EF-EM 90.3 – SPORTSKO RADIO SHPKNJP import-eksport Shkup obligohet që t'i shfrytëzojë mjetet e ndara financiare për qëllimin e përcaktuar me paragrafin 1 të kësaj pike.

2. Mjetet financiare nga pika 1 e këtij Vendimi, janë paraparë me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, për vitin 2022 dhe të njëjtat paguhen në llogarinë e EF-EM 90.3 – SPORTSKO RADIO SHPKNJP import-eksport Shkup, me numër 300000002196892, deponues në Bankën Komerciale SHA Shkup, me numër tatimor 4030998342288.

3. Për ndihmën e ndarë financiare – donacionin nga pika 1 e këtij Vendimi, lidhet kontratë për donacion ndërmjet Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe EF-EM 90.3 – SPORTSKO RADIO SHPKNJP import-eksport Shkup, e cila hy në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e të dy palëve kontraktuese, ndërsa do të zbatohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga ana e Ministrisë së Drejtësisë së RMV-së.

4. Ky vendim hy në fuqi me ditën e miratimit dhe do të publikohet edhe në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Arsyetime

Deri te Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) nga ana e Zyres së Kryetarit të Qeverisë së RMV-së, më datë 20.09.2022 ishte dorëzuar një Njoftim për kërkesë për përkrahje nga ana e "Sportsko Radio 90.3 fm", me nr.ark. 08-2520/2 nga data 16.09.2022, nr. i ynë arkiv. 03-3483/1 nga data 20.09.2022), me shtojcë të Shkresës së EF-EM 90.3 – SPORTSKO RADIO SHPKNJP import-eksport Shkup (nr.ark. 08-2520/1 nga data 15.09.2022). Me njoftimin në fjalë, Qeveria e RMV-së i rekomandoi Agjencisë si trup rregullues që mundëson zhvillimin dhe përkujdesjen për radiodifuzerët, që ta përkrah jubileun e 30-të ndërkombëtar "Turne në futboll të vogël për media 2022" në kuadër të kompetencave dhe mundësive të veta ligjore. Njëherë deri te Agjencia, më datë 26.09.2022, nga ana e EF-EM 90.3 – SPORTSKO RADIO SHPKNJP import-eksport Shkup ishte parashtuar edhe Kërkesë për përkrahjen e evenimentit tradicional "Turne në futboll të vogël për media 2022", me nr. 0306-5/2022 nga data 26.09.2022 (nr. i ynë arkiv. 05-3518/1 nga data 26.09.2022), me qëllim që Agjencia përmes ndarjes së një donacioni, ta përkrah turneun e 30-të jubilar ndërkombëtar. Duke marrë parasysh se përkrahja e jubileut ndërkombëtar "Turne në futboll të vogël për media 2022", do të kontribuojë për promovimin e sportit profesional dhe rekreativ, stimulimin dhe zhvillimin e kulturës dhe pëmbajtjeve sportive, si dhe afirmimin e shprehive të shëndetshme dhe kulturës fer-plej, në bazë të nenit 20 paragrafi 1 alinetë 1 dhe 15, në lidhje me nenin 18 paragrafi 1 alineja 18 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, nenet 4, 6, 7, 9, 10 dhe 11 nga Ligji për donacione dhe sponsorisime të veprimtarive publike, neni 39 paragrafi 1 alinetë 1 dhe 15 dhe neni 15 paragrafi 1 alineja 17 nga Rregullorja e punës së Agjencisë dhe Konkluzionit të Këshillit të Agjencisë, nr.ark. 02-3547/3 nga data 29.09.2022. Drejtori i Agjencisë solli vendim për ndarjen e ndihmës financiare – donacionit për EF-EM 90.3 – SPORTSKO RADIO SHPKNJP import-eksport Shkup me qëllim të përkrahjes së aktiviteteve të radiodifuzerit për organizimin e turneun e 30-të jubilar ndërkombëtar "Turne në futboll të vogël për media 2022" në shumën prej 250.000,00 (dyqind e pesëdhjetë mijë) denarë. Në pajtim me këtë vendim, EF-EM 90.3 – SPORTSKO RADIO SHPKNJP import-eksport Shkup, obligohet që t'i shfrytëzojë mjetet e ndara financiare për qëllimin e përcaktuar me pikën 1 paragrafi 1 të kësaj pike. Mjetet e ndara financiare nga pika 1 e këtij vendimi, janë të parapara në Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022 dhe të njëjtat do të paguhen në llogarinë e EF-EM 90.3 – SPORTSKO RADIO SHPKNJP import-eksport Shkup, me numër 300000002196892, deponues në Bankën Komerciale SHA Shkup, me numër tatimor 4030998342288. Për ndihmën e ndarë financiare, lidhet kontratë për donacion ndërmjet Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe EF-EM 90.3 – SPORTSKO RADIO SHPKNJP import-eksport Shkup, e cila hy në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e të dy palëve kontraktuese, ndërsa do të zbatohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga ana e Ministrisë së Drejtësisë së RMV-së

Ky vendim hy në fuqi me ditën e miratimit dhe do të publikohet edhe në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele

Në bazë të së lartpërmendurës, u miratua vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Drejtör,
d-r Zoran TRAJÇEVSKI, d.v**

Ekzemplar i Vendimit të dorëzohet deri te:

- EF-EM 90.3 – SPORTSKO RADIO SHPKNJP import-eksport Shkup;
- Drejtuesi i EF-EM 90.3 – SPORTSKO RADIO SHPKNJP import-eksport Shkup;
- Ministria e Drejtësisë së RMV-së;
- Sektori për Financa dhe Logjistikë
- Sektori për Çështje Juridike dhe Furnizime Publike;
- Sektori për Përkrahje Informatike dhe Punë të Përgjithshme -Arkivi i Agjencisë.

